Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0937

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani si kryetare, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi si anëtar, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "Proglobal" Sh.P.K. të datës 24.11.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 10.11.2023 të Autoritetit Kontraktues - Ministria e Punëve të Brendshme për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit" me numër të prokurimit 214-23-3593-2-2-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 22.02.2023 merr këtë:

Vendim

I.Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Proglobal" Sh.P.K. me nr. 2023/0937 e datës 24.11.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 10.11.2023, të Autoritetit Kontraktues-Ministria e Punëve të Brendshme për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit" me numër të prokurimit 214-23-3593-2-2-1. kurse Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit me të dhënat si më sipër.

II. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës së ankesës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 18.04.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit" me nr. të prokurimit 214-23-3593-2-2-1. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 108,000.00€.

Me datë 10.11.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka anuluar aktivitetin e prokurimit për të cilin po bëhet fjalë. Me datë 14.11.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 17.11.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 24.11.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/0937.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:

- **Pretendimi i parë (I) -** *"Në fazën pas vlerësimit dhe rivlerësimit te ofertave, paraqet shkelje flagrante te dispozitave ligjore te nenit 62 te LPP dhe nenit 97 te RRPP".*
- **Pretendimi i dytë (II) -***"Kjo procedurë e prokurimit është publikuar me datën 13.04.2023, dhe AK ende nuk e prolongon e neglizhon procedurën përderisa arsyetohet ne faza dhe veprime përgjatë procesit te kohëzgjatjes se kontratës, përderisa pajisjet ekzistente dhe furnizimet mbeten pezull si rezultat i vet pezullimit te procedurës se prokurimit, ku rreziku është permanent nga veprimet apo mos veprimet te cilat i atribuohen zyrtareve përgjegjës te AK".*

- **Pretendimi i tretë (III) -** *"Autoriteti Kontraktues, pas hapjes se ofertave, pas vlerësimit, pas ri vlerësimit dhe pas urdhrit te OSHP, nuk mund ta anuloj aktivitetin e prokurimit".*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 24, 28, 52, 59, 62 dhe 69 të LPP si dhe nenin 17, 40 dhe nenin 97 të RRPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues që të miratohet ankesa ashtu që të kthehet lënda në rivlerësim.

Autoriteti kontraktues në vendimin për anulimin e aktivitetit të datës 10.11.2023 ka thkesuar se Ministria e Punëve të Brendshme në pajtueshmëri me nenin 62 të LPP-së pika 1.1 anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se: Nje shkelje e LPP-së ka ndodhur. Me rastin e rivlerësimit me qëllim të sqarimit të specifikave teknike dhe kushteve të realizimit të këtyre shërbimeve e ka shqyrtuar kërkesen për inicim nga njësija kërkuese e cila kërkesë është bartur në dosje të tenderit te aneksi 1 specifikimet teknike të detyrueshme dhe ka vërejtur se ka parrregullsi në këto specifika teknike të cilat edhe gjatë tenederimit nuk janë korigjuar pasi nuk ka pasur kërkesë për sqarime nga OE pjesëmarrës, në mes tjerash këto parregullsi janë si vijon: afati i kontratës do të parashihet të përfundoj brennda 36 muaj(3 vite), faza e parë e trajtimt do të jetë menjëher me nënshkrim të kontratës, dhe e dyta dy (2) vite pas fazës së parë. dhe nën 2. OE duhet të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të kontratës e cila do të realizohet në dy faza të rimbushjes përgjatë kontratës së nënshkruar. Kjo kërkesë është në kundërshtim me listën e çmimeve dhe matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit, në të cilën kanë ofertuar OE-të sepse, nga njësia kërkuse është kërkuar matja dhe mbushja e të gjitha aparateve**për një herë** dhe nuk është cekur në këtë listë matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit do të realizohet në dy faza të rimbushjes përgjatë kontratës të nënshkruar. Me rastin e kryerjes së shërbimit - matja e Hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kunder zjarrit, kryhet sasia dhe nuk mbetet për fazën e dytë ri-mbushim prap aparatet. Pas kësaj paqartësie gjatë vlerësimit, komisioni i ri i vlerësimit e ka parë të nevojshme ta konsultoj njësin kërkuese dhe nga ta ka pranur përgjigje se me reastin e përgaditjes së specifikimeve teknike, jane bërë gabime të shumta teknike të cilat nuk mund të rregullohen apo parandalohen përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, kurse gjatë realizimit të kontratës krijojnë parregullsi ligjore të cilat nuk munden të tejkalohen.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 24.11.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 10.12.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim*".

Bazuar në nenin 105 të Ligjit për Prokurimin Publik, Paneli, i pakënaqur me ekspertizën e mëparshme që nuk arriti të argumentojë bindshëm nevojën për rishikimin e aktivitetit të prokurimit, vendosi të kërkojë një super-ekspertizë. Ky veprim u konsiderua jetik për të analizuar në detaje të gjitha argumentet nga të dyja palët, për të garantuar një vlerësim të drejtë dhe të plotë të çështjes, duke u siguruar që vendimi final do të mbështetet mbi një bazë të gjërë analize dhe drejtësie.

Andaj duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 29.01.2024 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar

të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues dhe pohimeve te AK. Me datë 14.02.2022 është pranuar Super ekspertiza e Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, në të njëjtën kohë mbetet në fuqi vendimi për anulim të aktivitetit të prokurimit.*"

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, super ekspertizën e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin e parë të operatorit ekonomik ankues, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: *"Fillimisht sqarojmë se arsyetimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit në rastin konkret nuk është në kundërshtim me vendimin paraprak të OSHP-së, pasi në rastin paraprak anulimi është bërë me arsyetim se të gjithë OE-të janë të papërgjegjshëm, ndërsa tani arsyeja e anulimit është se "Specifikacioni i detyrueshëm ka parregullsi ne specifikat teknike. Pra tani kemi të bëjmë me rrethana dhe situatë krejt tjetër nga ajo në rastet e mëparshme, pasi çështja e parregullsive në dosje të tenderit nuk ka qenë objekt i shqyrtimit me vendim të mëhershëm të OSHP-së për këtë aktivitet të prokurimit. Ndërsa sa i përket arsyetimit të AK-së se sipas njësisë kërkuese është kërkuar rimbushja "për një herë", ndërsa në dosje parashikohet që kontrata të realizohet në "dy faza" dhe me rastin e rimbushjes kryhet sasia dhe nuk mbetet për fazën e dytë të rimbushin prap aparatet, vlerësojmë se është i pabazuar pasi askund në dosje të tenderit nuk ceket se rimbushja bëhet "për një herë. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është pjesërisht i bazuar*".

Lidhur me pretendimin e dytë të operatorit ekonomik ankues, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: *"Parimisht pajtohemi me konstatimet e OE ankues, që sipas ligjit dhe rregullave në fuqi dosja e tenderit dhe kërkesat e AK-së duhet të jenë të qarta dhe precize. Megjithatë në rastin konkret, ashtu siç është konstatuar nga komisioni vlerësues pas përgjigjeve të marra nga njësia kërkuese, kjo dosje e tenderit ka të meta (defekte) të cilat e pamundësojnë realizimin e kontratës në pajtim me procedurat për mirëmbajtjen dhe aparateve kundër zjarrit, ku kontrollimi i tyre duhet të bëhet çdo 6 muaj. Rrjedhimisht kufizimi-limiti nga AK për rimbushje vetëm dy herë gjatë kohëzgjatjes 36 muajshe, ia pamundëson AK-së rimbushje tjera në rast se shfaqet nevoja, p.sh. pas përdorimit të aparatit në rast të ndonjë zjarri. Vlerësimi jonë është se ky kufizim paraqet pengesë e cila rrezikon mirëmbajtjen dhe rimbushjen e aparateve në mënyrë të rregullt varësisht nga nevojat që mund të shfaqen në terren gjatë periudhës tri vjeçare."*

Lidhur me pretendimin e tretë të operatorit ekonomik ankues, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: *"Ashtu si e cekëm më lart në pretendimin nr.2, kufizimi i rimbushjes për vetëm dy herë të aparateve për periudhë 3 vjeçare e pamundëson rimbushjen ne rast të shfaqjes së nevojës pas kontrollit të aparateve në pajtim me nenin 17 par.2 të ligjit për mbrojtje nga zjarri. Pas analizimit të mëtutjeshëm të shkresave të lëndës, konkretisht të raportit të komisionit rivlerësues, kemi gjetur po ashtu se disa nga arsyet/defektet kryesor në këtë dosje të tenderit, nuk janë bartur fare në njoftimin mbi vendimin e AK-së për anulim të aktivitetit. Në raportin e komisionit rivlerësues është konstatuar se nga 3 llojet aparateve, të cilat janë me mbushje me pluhur, me mbushje me CO2, dhe me mbushje me ujë, vetëm për aparatet me mbushje me pluhur janë paraparë kushte dhe specifikacion teknik se si duhet të jetë mbushja e tyre. Aneksi 1, pika 3: "3. Pluhuri për mbushjen e aparateve kundër zjarrit duhet të jetë për klasat e zjarreve ABC, minimum pluhur 40%, (duhet të prezantohen Certifikata për kualitet dhe të dorëzohet së bashku me ofertën)". Pra përveç aparateve me mbushje me pluhur, për asnjë nga llojet e tjera të aparateve nuk është parashikuar specifikim teknik konkret. Mendimi jonë është se kjo krijon hapësirë që mirëmbajtja ose rimbushja e aparateve tjera të bëhet sipas dëshirës ose vullnetit të lirë të kompanisë së kontraktuar, pasi në dosje të tenderit nuk ekzistojnë parametra të cilat duhet të respektohen nga OE. Nga analizimi i shkresave të lëndës, nuk kemi gjetur se AK e ka përshkruar këtë fakt në njoftimin mbi vendimin e AK për anulim, andaj mbi këtë bazë konsiderojmë se ankesa e OE ankues duhet të aprovohet si pjesërisht bazuar, pasi OE ankues nuk ka qenë njoftuar me gjitha arsyet e komisionit për anulim të këtij aktiviteti. Nga gjitha këto që u cekën më lart, vlerësojmë se AK-MPB nuk ka vepruar në pajtim me nenin 9 të LPP-së duke mos bërë përcaktimin e saktë të nevojave që duhet përmbushur. Po ashtu vlerësojmë se AK nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 28 të LPP-së duke hartuar një specifikacion teknik i cili nuk përkon me nevojat e AK-së e po ashtu nuk përkon me obligimet ligjore që dalin nga ligji për mbrojtjen nga zjarri. Ne pajtohemi me konstatimet e OE ankues se gjitha këto nuk janë gabime ose lëshime me fajin e operatorëve ekonomik dhe për të njëjtat nuk duhet te dëmtohen OE-të, megjithatë mendimi jonë është se kemi të bëjmë me lëshime/defekte serioze në dosje të tenderit të cilat e rrezikojnë apo edhe pamundësojnë realizimin e mirë të kontratës në krahasim me nevojat e AK-së dhe dispozitave ligjore nga ligji për mbrojtje nga zjarri, dhe se anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë në pajtim me nenin 62 par.1, nënpar.1.1 të LPP-së.*

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues sipas raportit te dates 14.02.24 i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues i ka falur besimin konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe duke vlerësuar të gjitha provat dhe argumentet me një qasje objektive dhe profesionale, Paneli Shqyrtues ka arritur në përfundimin

se vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit është i arsyeshëm, duke i përmendur arsyet specifike për këtë vendim. Në dallim nga vendimi paraprak i OSHP-së, Autoriteti Kontraktues nuk ka thënë se të gjithë operatorët ekonomikë janë të papërgjegjshëm, por tani ka identifikuar gabime të veçanta në specifikat teknike të detyrueshme për operatorët ekonomikë. Ky pohim i AK është e mbështetur nga konstatimi i super-ekspertizës, e cila ka evidentuar defekte të rëndësishme në dosjen e tenderit që pengojnë zbatimin e kontratës. Për shembull, kufizimi për rimbushje të aparateve kundër zjarrit vetëm dy herë në 36 muaj, pa mundësinë për rimbushje shtesë nëse lind nevoja, është një pengesë e qartë për mirëmbajtjen e duhur. Pranimi i gabimeve nga AK dhe anulimi i procedurës bazuar në këto gabime reflekton përpjekjen për të garantuar një proces prokurimi transparent dhe të drejtë, duke u përputhur me ligjin për prokurimin publik dhe parimet e tij. Për më tepër Si të tilla, këto shkelje për shkak të gabimeve që janë lëshuar gjatë hartimit të para masës në dosjen e tenderit të argumentuara nga njësia kërkuese nuk mund të rregullohen apo parandalohen me asnjë ndryshim të ligjshëm në kuadër të aktivitetit përkatës të prokurimit.

Për panelin nuk është kontestues fakti se përgjegjësinë për të hartuar specifikat dhe para masën e dosjes së tenderit e ka njësia kërkuese sipas dispozitave të RRPP që janë cituar më sipër. Njëkohësisht nuk është kontestues as fakti që pikërisht njësia kërkuese ka deklaruar për gabimet e lëshuara gjatë hartimit të para-masës në dosjen të tenderit të cituara si më sipër. Ngjashëm nuk është as kontestues fakti se zyrtari përgjegjës i prokurimit me datë 10.22.2023 në kuptim të nenit 11 paragrafit 11.3. nën-paragrafit b) lidhur me nenin 43 paragrafin 43.1. të RRPP ka publikuar edhe njoftimin mbi vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Mirëpo në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të kësaj lënde, shkeljeve dhe qëllimit të aktivitetit të prokurimit, Paneli mori parasysh nenin 62 të LPP pika 1.1 sipas të cilit AK mund të përfundojë një aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës nëse"një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit". Realisht mbi bazën e kësaj dispozite Paneli vendosi që ti aprovoj pjesërisht pretendimet ankimore te ankuesve. .

Paneli Shqyrtues konsideron po ashtu se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore dhe pohimeve të AK, të cilat Paneli sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i këtij aktiviteti në Rivlerësim duke pasur parasysh natyrën e këtij aktiviteti po ashtu thirrjen nga njësia kërkuese (nga aspekti profesional), paneli sipas gjykimit të pavarur konsideron se nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Po ashtu duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për panelin shqyrtues dhe çdo raport i tillë vlerësohet dhe analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës,

pohimeve te palëve, akteve dhe veprimeve të tyre, natyrisht duke e pasur parasysh edhe natyrën e shkeljeve eventuale në raport me qëllimin dhe rrjedhën e një aktiviteti të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli Shqyrtues e mbështet ndonjë raport apo ndonjë rekomandim të ekspertizës, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional te panelit ashtu siç i adresohen kompetencat e tilla sipas nenit 105 te LPP.

Andaj pas një vlerësimi të kujdesshëm të të gjitha provave, Paneli arriti në përfundimin se ankesa e Operatorit Ekonomik duhej pranuar si pjesërisht e arsyeshme, duke mbështetur njëkohësisht edhe vendimin e Autoritetit Kontraktues për të anuluar aktivitetin e prokurimit. Kjo qasje, e udhëhequr nga parimet e barazisë dhe drejtësisë që ndjek prokurimi publik, çoi në vendimin për rimbursimin e tarifës së ankesës, Në këtë mënyrë, paneli synon të garantojë që asnjë palë të mos penalizohet në mënyrë të padrejtë si rezultat i ndonjë lëshimi të ndonjjë gabimi nga ana e Autoritetit kontraktues duke demonstruar një përkushtim të qartë ndaj transparencës, integritetit, dhe drejtësisë në menaxhimin e çështjeve të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, duke vepruar nën autoritetin që i është dhënë nga Ligji për Prokurimin Publik (LPP), konkretisht nga nenët 103, 104 (paragrafi 1), 105, dhe 117, ka vendosur të përdorë të gjitha kompetencat e veta ligjore për të zbatuar një procedurë të shqyrtimit të prokurimit që është jo vetëm e shpejtë dhe e drejtë, por edhe pa diskriminim dhe e përqendruar në arritjen e një zgjidhjeje ligjore dhe efikase për çështjet në fjalë. Kjo qasje reflekton një angazhim të thellë ndaj parimeve të barazisë, transparencës dhe drejtësisë në menaxhimin e proceseve të prokurimit publik.

Më tej, Paneli Shqyrtues ka bërë një kërkesë të prerë drejtuar Autoritetit Kontraktues për të ushtruar një vëmendje të lartë në zbatimin e procedurave të prokurimit publik. Kjo vëmendje përfshin respektimin e plotë të udhëzimeve dhe normave të parashikuara në Ligjin për Prokurimet Publike dhe në legjislacionin përkatës që mbulon sferën e prokurimeve publike. Paneli thekson nevojën për veprim në përputhje të plotë me konkluzionet dhe vendimet e tij, duke garantuar që çdo veprim dhe vendim të marrë nga Autoriteti Kontraktues të jetë i motivuar nga synimi për të siguruar që proceset e prokurimit të zhvillohen jo vetëm në përputhje me ligjin, por edhe në mënyrën më të drejtë dhe transparente që është e mundur. Kjo metodë kontribuon në mbrojtjen e integritetit të procesit të prokurimit dhe në forcimin e besimit të ofertuesve dhe të gjithë publikut në sistem.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **PROGLOBAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: